



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 292/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziq dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan, për shkak të pengimit për mbajtjen e tubimit në shkollën fillore Shtjefan Gjeqovi në Janjevë, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), dega në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 21.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Lipjan, në të cilën theksohet se me dt 20.10.2013 në orën 19.00 LVV gjate organizimit te fushates zgjedhore për Kryetar Komune në Lipjan eshte penguar gjate mbjatjes se tubimit ne shkollen fillore Shtjefan Gjeqovi ne Lipjan nga anetare te Partise Demokratike te Kosoves dhe se nga kjo pretendojnë se me këtë veprim ka shkelur nenin 33 pika a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3 pika a të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nenit 3.6 për Rregullat Zgjedhore 13/2013, si dëshmi ka bashkangjitur nje deklarate si dhe formularin e njoftimit per mbajtjen e tubimit politik .

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, ku konsideron se jane te pabaza pretendimet e LVV-së lidhur me shkeljen e rregullave te percaktuara ne nenin 33 pika d LVP. Sipas PDK, ngjarja nuk eshte prezantuar ashtu siq e paraqet LVV, me qe rasti eshte paraqitur ne polici PDK eshte ne pritje qfare hapa do te ndremarre policia e Kosovës. PDK konsideron se PZAP nuk duhet te ndermarre asnje veprim lidhur me kete ankese pa pas ne dispozicion deklaratat zyrtare te policise si dhe ta hedh poshte këtë pretendim te LVV-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik PDK ka penguar mbajtjen e tubimit të LVV-së në shkollën fillore Shtjefan Gjeqovi në Lipjan, PZAP-i i vlerësoi të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, dhe se një ankesë e tillë nuk mund të konsiderohet si e bazuar, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 292/2013 më datën 25.10.2013

Kryesuesi Panelit
Behat Idrizi



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*